

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Krejt radarët e shtetit i mbyll për ty"/ MESAZHET që shkëmbyen Vlora Hyseni dhe Ergys Agasi: Të du! Gazeta Shqip
ADRESA	https://gazeta-shqip.com/me-rendesi/krejt-radaret-e-shtetit-i-mbyll-per-ty-mesazhet-qe-s-hkembyen-vlora-hyseni-dhe-ergys-agasi-te-du/
BURIMI	gazeta-shqip.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 19:33:02 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 16:12:13 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fea96a649e2ceb6a20e6d5330678241435c30673e5d363dc5d96996b4edd8b73
TEKSTI	d876a16b54d504801fc1fdea6c5583a67199e3f51839380c9060bac14a7f2007
PAMJA	b262cce28d05807934d20b7153494bf1d1a21db31d44d3e97eb4a736581030fa

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c2f7882e2c76b46c40aa63aa30ffc6d94ff3630b9684248ffb441fb869587b1d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	20cb9bc098b6b22129b01f41a10ad3ad7e12cceb89fa0b5f21647847572e06c6
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c2f7882e2c76b46c40aa63aa30ffc6d94ff3630b9684248ffb441fb869587b1d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

ME RËNDËSI

“Krejt radarët e shtetit i mbyll për ty”/ MESAZHET që shkëmbyen Vlora Hyseni dhe Ergys Agasi: Të du!



15:12 | 24 SHTATOR 2026

SHPERNDA ▾

Detaje të reja nga dosja hetimore e SPAK kanë hedhur dritë mbi natyrën e komunikimeve mes biznesmenit Ergys Agasi dhe ish-drejtuës së Shërbimit Informativ të Shtetit, Vlora Hyseni.

Mes materialeve të bëra publike ndodhen edhe biseda ku Hyseni, sipas dosjes, e këshillon Agasin të mos përdorë një prej numrave të tij të telefonit, duke lënë të kuptohet se ai mund të ishte nën vëzhgim.

“Shpirt mos e përdor atë numrin tjetër sonte se çunat ia kanë çu veshin. Flej rehat. Të du!”, citohet mesazhi që Hyseni i ka dërguar Agasit.

Biseda vijon me një pyetje të Agasit lidhur me sigurinë e disa personave të cilëve ai u referohet si “djemtë e mi”.

“Shpirt, a ka naj rrezik për djemtë e mi sonte?”, citohet të ketë pyetur ai.

Sipas materialeve të publikuara, përgjigjja e Hysenit ka qenë: “Flej rehat zemër, krejt radarët e shtetit i mbyll për ty”.

Këto komunikime janë bërë publike në një kohë kur Hyseni ndodhet në fokus të hetimeve. Katër ditë përpara se t’i komunikohet masa e sigurisë “arrest në shtëpi”, ish-drejtuësja e SHISH ishte marrë në pyetje nga Prokuroria e Posaçme si person në dijeni për raportet e saj me Agasin.

Gjatë dëshmisë, Hyseni kishte pranuar se kishte pasur kontakte me

biznesmenin, por i kishte mundur ato me funksionin qe mbante. Mesazhet e publikuara me pas paraqesin, megjithate, nje komunikim me tone personale mes tyre, cka eshte bere pjesë e materialeve të hetimit.

Agasi u arrestua me 26 gusht në kuadër të hetimeve për çështjen e AKSHIT.

Sipas të dhënave të dosjes të bëra publike, në një seancë gjyqësore Agasi ka deklaruar se dokumentet i kishte lënë qëllimisht në automjet, me synimin që ato të gjendeshin nga hetuesit e SPAK.

Komunikimet e administruara nga telefonat e Agasit dhe Hysenit, që përfshijnë periudhën nga fundi i qershorit deri në arrestimin e biznesmenit me 26 gusht, janë tashmë pjesë e provave që po shqyrtohen nga organet e drejtësisë. Përmbajtja e tyre tregon një komunikim me personal sesa një marrëdhënie e kufizuar vetëm në formulime zyrtare apo profesionale.



GAZETA SHQIP

Rreth nesh
Marketing
Newsletter
Mundësi Punësimi
Kontakt

TOP ALBANIA RADIO

News
Shows
Video
Podcasts

MORE

Top Channel
TimeOutTirana
Top Music Awards

SOCIAL



Newsletter

Regjistrohu

[Privacy Policy & Terms of Use](#) | [Cookie Policy](#)

gazeta shqip

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.